


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj.

Në bazë të dispozitave të nenit 44.1 pika Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e katërt të rregulltë të K.K-sës, e cila do të mbahet më **30.04.2018** (e hënë) duke filluar në ora **11:00**.


R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Raporti financiar për tremujorin e parë (janar-mars) 2018;
3. Shqyrtimi i riorganizimit të komisionit për dhënjen e tokës Komunale në shfrytëzim në bazë të kërkesës së qytetarëve;
4. Vizit studimore e punës, rrëth Kornizës Afatmesme Bugjetore për vitin 2018 - 2020;
5. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 19.04.2018
Në: Novobërdë

Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 29.03.2018, duke filluar në orën 11.00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Bajrush Ymeri, anëtarët Predrag Stojkovic, Negovan Jovanovic, Ivica Cenic,Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Xhevat Mehmeti, Xhejlane Behluli, Abdyl Gashi, Ramush Mehmeti, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Drejtori i Arsimit Adem Abazi, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, zyrtar komunal si dhe një numër i qytetarëve.

Kryesuesi Nebojsa Arsic pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezent janë të gjithë antarët e Kuvendit dhe mund të fillojmë me këtë:

Rendite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
 2. Raporti i Drejtoris së Arsimit për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë;
 3. Informata e Drejtoris për Zhvillim Ekonomik për ndryshimet në Rregulloren mbi orarin e punës së bizneseve;
 4. Shkarkimi i komisionit të vjeter dhe formimi i komisionit të ri për ndryshimet në Rregulloren për pagesën e tatimit në pronë;
 5. Bartja e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2017 në vitin 2018, nga të hyrat vetanake;
 6. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit a pajtohen më këtë rend ditë apo keni ndonjë propozim?

Pasi nuk pati propozime rendi i ditës u aprovua unë i lëshoje ligj të kujdesit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kalarat e Kuvendit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Basi nuk pati vërejtje procesverbali u aprovua unanimishtë nga anëtarët e Kuvendit.

Pasi nuk pao vejtjej processuarën e parë, Reporti i Dreitorisë së Arsimit përfundimini gjysmëvjetorit të parë;

Pika e dytë: Raporti i Drejtoris se Arsimit per perran. 31.
Kjo është këshilla që dha filion Dreitorit të Arsimit zt. Adem Abazi.

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën Drejtoret te Arsimit të Këshillit të Komunës. Adem Abazi pasi përvendetetë të pranishmit tha: siç e dini DAK e ka për obligim ligjor që për përfundim të gjysëmvjetorit të raportoj në Kuvend rreth zhvillimit të punëve në Arsim në të gjitha shkollat e Komunës tonë. Për kshilltarët e rinjë po ju informoj shkurtimi i statistikave në sektorin e arsimit në komunënë tonë, edhe pse jemi një Komunë me popullsi jo të madhe Komuna e Novobërdës i ka 25 institucione arsimore, duke qenë një territor mjast i madhë dhe me një numer të vogël të popullësis

poashtu me numër të madhë të shkollave kjo po ndikon që çdo vit shkollor të kemi mungesa të jashtzakonshme në askpektin buxhetor, pas që sipas ligjeve në fuqi të Ministrisë së Arsimit dhe udhëzimeve administartive buxhetet ndahen për numër të nxënësve dhe kjo neve si Komunë po na dëmton vazhdimishtë, ne si Komunë me 25 shkolla kemi buxhet për kategorin e mallrave dhe sherbimeve rrëth 60.000 €, kaq buxhet mund ti ndahet një shkolle në qytet, por kjo është formul e financimit që ne si Drejtori nuk mundë të ndërrhyjmë pasi që është ligj financiar, andaj kisha kërkua nga kshilltarët Komunal s sa herë të bisedohet për arsimin të keni parasysh që të përkrahni propozimet që kanë të bëjnë me rritje të buxhetit sepse sipas qarkores buxhetore nga grandi i përgjithshëm jo vetem që lejohet por obligohet ti ndihmohet sektorit të arsimit. Viti shkollorë 2017/18 ka filluar me rregull sipas ligjeve dhe udhëzimeve administartive në fuqi, nuk kemi pasur ndonjë problem që do të mund ta pengonte fillimin e këtij procesi, kan përfunduar më kohë të gjitha punët që i takojn DAK siç janë konkurset për nxënës dhe konkurset për staf, shkollat janë furnizuar me material të nevojshëm aq sa kemi pasur mundësi financiare, e di qe me vones e kemi derzuar raportin por nuk kemi pasur mundësi ta sigurojm më herët, janë rapportete qe na informojm për sukseset dhe mungesat te nxënësve, fatkeqësisht numri i mungesave çdo herë është në rritje mund të ketë arsyet e ndryshme si gripi sezonal apo ndonjë arsyet tjetër, nuk isha zgjeru më shumë për këtë raport pasi që e keni secili prej jush nese ka ndonjë pyetje apo sugjerim do tju përgjigjem, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë. Xhevati Mehmeti pasi përhendetë të pranishmit tha: i kam dy pyetje për ju, materialin e kemi marrë vetem në gjuhen shqipe për shkollat shqipe mendoj se kishe qenë më mirë ti kemi për të gjitha shkollat dhe pyetja tjeter është për shkollen në fshatin Pasjak pasi që Drejtori i kësaj shkolle ka marrë një vendim që të punohet vetem me një ndrrim si klasa e IX si klasa I, a e lejon ligji këtë a është në rregull?, ju që t'ë faleminderit.

Adem Abazi tha: falemenderit për pytjet, materialin e kemi siguruar sotë në gjuhen serbe dhe teknikisht nuk kemi arrit me i pregadit për të gjithë, mirëpo këto janë statistika personale të shkollave, nese një deputete e përfaqëson një komunitete apo zonen i ka ato statistika që janë nga zona e tij por kjo është vetem qështje teknike nese e shifni të arsyeshme më vonë mundë të ju sigurojm të gjithve nga një kopje, ndërsa sa i përket shkollës në Pasjak jam i informuar që shkolla është një ndrrim por është hera e parë që po ndëgioj se ka një ankes ose një mospelqim me atë vendim, është në rregull pasi që ka shumë shkolla që janë dy ndrrime sa i përket aspektit ligjor nuk besoj se ka diçka tkeqe, do të ishte e keqe nese shkolla bie vendim që ta zvogloj minutazhen e mësimit apo nese shkolla fillore dhe e mesme e ultë e interferojn punën njëri tjetrit ne marrim masa, por deri tash është hera e parë që dëgjoj një ankesë, ju e keni këshillin drejtues të shkollës ku janë edhe këshilli i prindërve dhe nese ju e shihni të arsyeshme që shkolla të punoj në dy ndrrime atëher ne do të veprojm.

Xhevat Mehmeti tha: unë sa e di kurikula e re nuk e lejon klasen e IX dhe I të punojn me një ndrrim, pasi që fizikisht mundë të lendohen nxënësit, kjo nuk është kërkes e imja por e gjithë qytatarve të shatit, një kshillatërë në Ministri më ka treguar që nuk lejohet, nese ndodh që një nxënës i klases së IX ta lendoj nxënësin e kl I kush do të merr përgjegjësi, kur e kam pytur drejtorin e kësaj shkolle se përfarë arsyë ka marrë një vendim të tillë është përgjigjur që për shkak të hargjimeve me lëndë djegëse, prandaj kërkes e imja dhe e gjithë qytetarëve është që kjo shkoll të punoj me dy ndrrime sikur ka qenë më herët, ju faleminderit.

Adem Abazi tha: edhe një herë të falemenderoj për pytje dhe interesimin e shprehur, e thash edhe me herët që nuk kam pasur ndonjë sugjerim ose ankes prej asnjë prindi ose qytetari të atij fshati, drejtoret e shkollav jan të kyçr drej për drejt me zbatimin e kurikules së re dhe besoj që janë shumë më të informuar se drejtoria e arsimit pasi që ata janë në trajnime të zbatimit të kurikules dhe nese është anti ligjore siç po thuni ju ne do të marrim masa pasi që ne punojm për interesa të nxënësve dhe jo të drejtorave të shkollave, ka qenë arsyetimi i tyre që mundësit janë për tu zhvilluar mësimi një ndrrim dhe skemi pasur

Procesverbali i Kuvendit

asnjë ankesë deri më tanë, shumica e shkollave në Komunën tonë janë një ndrrimëshe por nese ju jeni përti mbrojtë interesat e nxënësve ne jemi me juve në zbatim të ligjit, ju falminderit. Ramush Mehmeti pasi përvendetë të pranishmit tha: këtë pikë e kemi shqyrtu edhe në KPF dhe të gjithë antarët e KPF e kemi konstatuar se gjendja në arsim është shumë e vështirë dhe kërkes e jona ka qenë që nese ka mundësi të rritet buxheti në drejtori të arsimit pasi që u cekën disa raste ku drejtoria e arsimit nuk ka mundur ti përkrah nxënësit e shkollave për arsyet e mungesës buxhetore siç ishte transporti në disa gara dhe kisha kërku nga të gjithë që këtij sektori ti ipet përparsi, raportin siç e tha edhe drejtori nuk e kemi marrë me kohë materialin por besoj se në të ardhmen nuk do të përseritet dhe ne si raport e kemi përkrahur dhe do ta përkrahmi edhe në vazhdim por kërkoi që unanimisht çdo herë të përkrahmi rritjen e fondeve në arsim, ju faleminderit.

Xhevati Mehmeti tha: e kam edhe një pyetje për drejtorin, kur është ndërtuar shkolla në Pasjak e kemi pasur në marrëveshje që të rrënohet shkolla e vjetër që të lirohet hapsira prandaj kisha kërku që ajo marrëveshje të zbatohet plotësisht, ju faleminderit.

Adem Abazi tha: e dini se kam qenë i kyqur gjatë gjithë kohes në këtë proces, i kam kryer të gjitha obligimet që i ka marrë drejtoria e arsimit në raport me komisionin evropian, obligimet teknike që i kemi pasur për tu zhvilluar ky projekt, kam thënë edhe në përrurim edhe sot po them që krenohem me shkollën në Pasjak pasi që është një prej shkollave e ndërtuar dhe e rregulluar me standarde evropiane, nuk them që nuk ka mangësi dhe lshime por ne do ti përbahemi obligimeve që i kemi marrë, sa i përket shkollës ka pasur zëra që kërkojn të renovohet dhe të përdoret si laborator ose si muze, rrrenimi mundë të bëhet për dy orë por të rinovohet kërkon kohë më të gjatë por nese ju si qytetarë e shihni se është penges.

bëhet për dy orë por të rrimovonet kërkoi pasi që mës ta rrënojmë. ne si Komunë dhe drejtori nuk kemi asnjë arsyé që mës ta rrënojmë. Xhevati Mehmeti tha: sa për infomacion ne jemi që ta rrënojm qysh neser në mënyrë që të zbatohet marrëveshja me Bashkimin Evropian, unë kam qenë monitorues prandaj kërkoi pasi që është kërkes e qytetarëve që të zbatohet marrëveshja dhe të rrënohet, kisha kërkoi që ti filloni procedurat tenderuese.

Adem Abazi tha: duhet të vihet një kërkes formale nga drejtori i shkolles ose keshtimi drejtues. Xhevati Mehmeti tha: drejtori i shkollës dhe kshilli drejtues nuk janë të interesuar që të rrenohet prandaj kisha kërkuar që të zbatohet marrëveshja.

kisha kerkuar që të zbatohet marrvesisja. Adem Abazi tha: duhet të vijë një kërkes formale në mënyrë që ne me i fillu procedurat. Abdyl Gashi pasi përshtendeti të pranishmit tha: tju ndihmëj pak pasi që është punë shumë e lehet dhe e zgjidhshme pasi që këshilli drejtues mund të thirr një takim me prindë dhe të marrë një vendim që Komuna duhet ta zbatoj, duke e pasur parasysh që Drejtoria e Arsimit është sektor shumë i rëndësishëm i Komunës pasi që aty rriten kuadro dhe është e ardhmja e Komunës dhe e shtetit, pasi që në Komuna tjetra ndahet buxhet edhe për shujta të ndryshme te ne jemi në një gjendje të buxhetit shumë të vogël të arsimit për shkak që rrëzikohen të humbin edhe mësmin pasi që mungon edhe ngrohja prandaj është shumë e rëndësishëm që të angazhohemi edhe më shumë per rritje te buxhetit në këtë sektor, ju faleminderit.

Kryesusi tha: edhe në KPF kemi dikutuar këtë pikë dhe kemi vërejtur që gjendja ne arsim nuk eshte mirë për arsyet mungesës së mjetave buxhetore.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesusi kaloj ne pikën e tretë.

Pika e tretë: Informata e Drejtoris për Zhvillim Ekonomik për ndryshimet në Rregulloren mbi orarin e punës së bizneseve;

orarin e punës së bizneseve; Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën Sabedin Vllasaliut zyrtar për Zhvillim Ekonomik Sabedin Vllasaliu pasi përhendeti të pranishmit tha: në mbledhjen e kaluar e kemi marrë një pelqim prej Kuvendit që të bëjm një ndryshim në rregulloren e fillimit dhe mbarimit të orarit të punës së bizneseve dhe kemi marrë për obligim që këtë rregullore tju prezantojm bizneseve në degjim publik në mënyrë që të marrim propozime prej tyre, ne jemi duke punuar në këtë drejtim ku kemi pasur disa takime me biznese, poashtu kemi pasur takime me jursit në mënyr që të punojm një rregullore sipas ligjeve në fuqi, ne nuk kemi mund të organizojm degjime publike në vendbani me më të mëdhaja ku ka më shumë biznes por

Procesverbal i Kuvendit

planifikojm në muajin prill ti organizojm këto dëgjime, arsyeva e mosorganizimit ka qenë edhe kushtet atmosferike poashtu edhe disa aktivitete që kemi pasur për punim të rregullores, këto dëgjime i planifikojm në muajin prill kryesishtë në këto fshatra: Llabjan, Koretish, Kufc dhe një degjim në sall të Kuvendit në mënyr që të prezantojm këtë rregullore dhe ti dëgjojm propozimet e tyre, nese keni ndonjë pyetje ose sugjerim i mirëpres nga ana juaj, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutim për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: me intereson të dij se deri ku keni arritur, a është skanu gjendja e bizneseve dhe sa lloje te bizneseve veprojne, në mënyrë që mos të vendosim orari për të gjithë njësoj, puna e parë është skanimi dhe takimi me biznese dhe mos ta mbahen dëgjime publike formale të cilat nuk kanë pru ndonjë vendim por përseri të caktohet orari ashtu si vendos Komuna, në mënyr që mos të dëmtohen bizneset edhe pse egzistojn pak biznese në Komunën tonë por të jemi shembull që edhe prej Komunave tjera të invesotjn në hapje të bizneseve në komunën tonë, ju faleminderit.

Sabedin Vllasaliu tha: në kuader të Drejtoris e kemi edhe sektorin e regjistrimit të bizneseve dhe e kemi listen e të gjitha bizneseve që egzistojnë në Komunë, e kemi bërë ndarjen në secilin vendbanim se sa biznese janë të regjistruala dhe e kemi një data bazë se çfarë lloje të bizneseve janë, ftesat do të bëhen për secilin biznes, do ti publikojm ftesat në web faqe të Komunës dhe në vendbanime të ndryshme, në takime do të prezantohet rregullorja dhe do të mirren mendimet e tyre për orarin e bizneseve për këtë aryse do të organizohen këto dëgjime publike.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesusi kaloj ne pikën e katërt.

Pika e katërt: Shkarkimi i komisionit të vjetër dhe formimi i komisionit të ri për ndryshimet në

Rregulloren për pagesën e tatimit në pronë;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic. Sercan Todorovic pasi përshendetë të pranishmit tha: do të formojm një komision për ti bërë disa ndryshime në rregulloren për pagesen e tatimit në pronë, më herët ka qenë i formuar një komision i kanë bërë disa ndryshime por ati komision i ka kaluar mandati për këtë arsyë do të formojmë një komision të ri, komisioni do të përbëhet prej 5 antarëve, 3 do të janë prej egzekutivit dhe 2 prej Kuvendit, antarët nga egzekutivi janë Sinisha Dimiq, Sava Simiq, Driton Mustafa na duhen edhe dy propozime prej Kuvendit, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: unë në KPF kam bërë pyetjen dhe përseni po potencioj, edhe pse me profesion jam agronom nuk jam jursit por kam diskutuar me komunat tjera dhe më kan thënë se Drejtorit Komunale jan obligative për propozimin e rregulloreve ndërsa Kuvendi Komunal vetem e aprovon, formimi i komisionit mendoj se duhet të bëhet nga Drejtorit, gjithashtu mendoj që në këtë komision duhet të jan ekspert të drejtorive përkatese dhe rregullorja pas diskutimeve publike te bihet në Kuvend dhe të votohet, mua më duket e paarsyeshme që antarët e Kuvendit të jan pjesë e këtij komisioni, nese është në pajtushmeri me ligjin në rregull, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: ky komision do të formohet për ti bërë disa ndryshime në këtë rregullore, e kemi një zyrtarë të zvillimit ekonomik, një zyrtar të pagesave të tatimit, gjithashtu i kerni disa kompani që do ti vlersojnë disa rrugë se sa do të paguajn tatimin.

Dobrivoje Djordojovic tha: më intereson komisioni që ka qenë më herët a janë përsieri ata antarë të këtij komisioni në mënyrë që të na informoj se sa kan punuar dhe ku kanë arritur.

Sercan Todorovic tha: para 2 viteve është formuar komisioni më herët që he kan bërë disa ndryshime, ky komision që do të formohet do të punojnë në ndryshimë të rregullores pastaj rregullorja do të sillet në Kuvend për miratim.

Zv.Kryesuesi Bajrush Ymeri pasi përshendetë të pranishmit tha: për këtë periudhë që po bisedohet kam qenë në poziten e Nënkyetarit të Komunës, kam marrë pjesë vazhdimisht në

Procesverbal i Kuvendit

imbledhje dhe e kam përcjell edhe këtë pikë që sot po diskutohet, nga komunitete serb antarë i këtoj komisioni ka qenë Predrag Stojkovci ndërsa nga komuniteti shqiptarë Xhevati Mehmeti dhe e dim se sa është diskutuar në mandatin e kaluar për këtë qështje, kemi pasur vazhdimisht kërkesa prej antarëve të Kuvendit që të diskutohet për rregulloren e tatimit në pronë, gjithashtu i kemi pasur në takim edhe zyrtar nga Ministria për këtë qështje, shqetësimet e parqitur kan qenë për fshtarat që janë larg qendres së Komunës dhe janë në zonë të parë si Kufca, Pasjaki, Koretishta. Komisioni më herët nuk është angazhu mjaftueshmë që të gjitha shqetësimet e ngritura të përfundohen, ende ka vërejtje rreth zonave, normave dhe shumës së caktuar që paguajn tatimpaguesit, andaj kisha kërkua që ky komision që formohet sot të mirren më seriozisht me këtë rregullore, të punojn për një rregullore që të jetë e përshtatshme për gjithë qytetarët që paguajn tatim në pronë, për mos me marr fjalen edhe një herë për antare të këtij komisioni propozoj Xhejlane Behluli, ju faleminderit.

Ivica Cenic pasi përshendetë të pranishmit tha: propozoj Dobrivoje Djordjovic.

Kryesuesi tha: pasi që nuk kemi tjera diskutime njëher të votojm për shkarkim të komisionit të vjetër.

Votohet njëzëri nga të gjithë antarët prezent (gjithsej 13 antar, 2 munguan në votim) që të anulohet vendimi i formuar më heret për komisionin e ndryshimeve në rregulloren e pagesave të tatimit në pronë.

Kryesuesi tha: tash të votojm për formim të komisionit të ri për ndryshime në rregulloren e pagesave të tatimit në pronë.

Aprovohet njëzëri nga antarët e Kuvendit (gjithsej 13 antar, 2 munguan në votim) kjo pikë dhe u pru ky: prua ky:

V E N D I M

FORMOHET Komisioni për ndryshimet në Rregulloren për Pagesen e Tatimit në Pronë më këtë përbërje:

1. Sinisha Dimiq
2. Sava Simiq
3. Driton Mustafa
4. Xhejlane Behluli
5. Dobrivoje Djordjovic

Pika e pestë: Bartja e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2017 në vitin 2018, nga të hyrat vetanake;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalen Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic tha: tju informoj se duhet të mirret vendim në Kuvend për bartje të këtyre mjeteve d.m.th janë mjete të paspenzuara të vitit 2017 nga të hyrat vetanake dhe duhet të barten në këtë vit, totatli i mjeteve për bartje është 46,483.19 €, e keni në materil për secilen kategori, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: a ka mundësi të bëhet një ndërhyrje në buxhet, kam propozuar edhe në KPF që 5,483.19 € të barten në Drejtori të Arsimit, ju faleminderit

Sercan Todorovic tha: këto mjete kanë qenë të planifikuar të shpezohet në vitin 2017 por ruk jan shpenzuar dhe nuk mund të barten në kode tjera por vetem në ato kode që kanë qenë të planifikuar.

Procesverbal i Kuvendit

Abdyl Gashi tha: ka buxhet të paspenzuar po ka pasur mundësi të investohet më shumë, duke e ditur që në arsim nxënësit e kan humbur mësimin pasi që nuk kanë pasur ngrohje, gjithashtu edhe në Komunë duke u nisur prej parkingit edhe në objektin e Komunës mungon higjena, është tmerruese për vizitorët e Komunës prandaj kërkoj që në këtë mandat të mos përsritet një gjë e tillë, ju faleminderit.

Pasi nuk pat diskutime tjera aprovohet njëzëri nga antarët prezent (gjithsej 13 antar, 2 munguan në votim) të Kuvendit kjo pikë dhe u pru ky:

V E N D I M

Aprovohet vendimi për bartjen e mjetet financiare nga të hyrat vetanake në shumë prej 46,180.52 € të vitit 2017 në vitin 2018

Bartja e mjeteve bëhet në këto kategori:

1. Kategoria Mallra dhe Sherbime ne vlerë prej	9,642.12 €
2. Kategoria e Sherbimeve Komunale në vlerë prej	509.65 €
3. Kategoria e Subvacioneve në vlerë prej	542.56 €
4. Kategoria e Investimeve Kapitale	35,483.19 €

Pika e gjashtë: Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.


Ramush Mehmeti tha: duke e parë gjendjen reale në Komuri pasi që zyrtarët nuk po kanë kushte të punës, nuk kan vetura zyrtare propozoj që Drejtoria e Financave të bëj një analizë, të shikohet mundësia që gjitha vetrurat e vjetra, të mirret vendim në Kuvend, të kemi një propozim konkret që vetrurat e vjetra të shiten, të mos shiten vetem ato që ja vlen të investohet, për pjesen tjeter të mendohen dy opsione ose të mirren vetura me qira në shfrytëzim sikur kan vepruar edhe Ministritë, ose të blehen vetura të reja, më mirë të jenë 5,6 vetura funksionale se sa 50,60 jo funksionale. Komuna e Novobërdës ka më së shumti nevoj për vetura kryasuar me Komuna tjera, është apsurde një zyrtë komunal mos të ketë mundësi të dal në një takim apo dëgjim publik, ose një Drejtore nuk ka mundësi të marrë pjesë në një takim për aryse të mungesës së vetrurës kjo është e papranueshme, prandaj të bëhet një propozim prej Drejtorisë së Financave dhe Drejtorisë së Administratës të bëhet një analiz reale të bihet në Kuvend dhe Kuvendi të merrë vendim më propozim të egzekutivit, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: e kam një shqetëzim për banorët e fshatit Llabjan pasi ata vazhdojnë të kenë mungesë të ujit të pijshém që 3 vite, ujësjelli aty egziston dhe është investu me qindra, mijra euro në ata ujësjellës, arsyetimet që i kemi marrë prej organeve Komunale kanë qenë që aty ka një mospajtim në mes të pronarit ku gjenden pompat e ujit dhe ai kërkon kompenzim për ti aktivizuar këto pompa, mundë të ketë të drejt apo jo nuk e di por përgjegjësia i takon Komunës që të bëj zgjidhje pasi që është një financim shumë i madhë dhe mos të mbetet peng për shkak të një individu, gjithashtu edhe projekti i ndriqimit ende pa i bërë 1 vit nuk funksionon çdo herë, këto projekte vetem mbesin në lëtëri pasi që nuk kanë mirëmbjatje dhe nuk tregojnë seriozitet si Komunë që në të ardhmen të kemi investitor të rinjë, ju faleminderit.


Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje dhe e mbylli mbledhjen në orën 12:00

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse

Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



RAPORTI FINANCIAR

I TE HYRAVE DHE TE DALURAVE PER PERIODIN

JANVAR - MARS 2018

PRILL - 2018

Shfrytëzimi i te hyrave dhe të daturave të shfrytëzuesve buxhetor për periudhen Janar-Mars 2018

Per te pasur nje pashqyri reale të shfrytëzuesve buxhetor po ju paraqesim raportin e shpenzimeve të planifikuara dhe te realizuara per periudhen Janar-Mars 2018

Nr.	Shfrytëzuesi i buxhetit	Kodi	Kodi i Drejtoris
1	Zyra e Kryetarit		16030
2	Administrata		16330
3	Zyra per komunikim		16490
4	Zyra per barazi gjinore		16530
5	Zyra e kuvendit komunal		16930
6	Buhxet dhe financa		17530
7	Inspektioni		16659
8	Sherbimet publike- mbrojtja civile		18190
9	Zyra per komunitete		19650
10	Bujqesi,pylltar i zhvill. rur.		47030
11	Zhvillim ekonomik		48030
12	Urbanizem		66455
13	Shendetesi dhe mbrojtje prim shend.		74800
14	Sherbimet sociale		75645
15	Kultur rini dhe sport		85030
16	Administrat sim		92150
17	Arsimi i mesem		95070
18	Arsimi fillor		93870
19	Arsimi parashkollor-kopshtet		92790

inkasimi eshte bere ne baze te Rregullores mbi taksat, ngarkesat dhe kamatat si dhe Rregullores per tatimin ne pron

Per tre majorin e pare 2018 kemi keto te hyra:

Te hyrat vetanake per muajt Janar, Shkurt dhe Mars

40110	Tc hyrat nga tatimi ne pron	12,402.80
50001	Te hyrat nga regj. i automjeteve	2,680.00
50009	Taksa komunale per leje te ndertimit	261.00
50011	Taksa komunale per regjistrimin e trashigur	738.27
50012	Taksa per ndrrimin e destinacionit te tokes	500.00
50013	Taksa per qertifikatat e lindjes	7,534.40
50014	Taksa per qertifikatat e kunorezimit	2,305.00
50015	Taksa per qertifikata te vdekjes	150.00
50019	Taksa tjera administrative	760.00
50019	Taksa per veritetimet prej 1 €	153.00
50019	Taksa tjera administrative -LISTA POSUEDUES	152.00
50408	Oraja nga objektet publike	558.00
50405	Qiraja nga prona publike	0.00
50409	Participimi ne shendetesi	139.60
	GJITHSEIT:	28,334.07

MJETETE HARXHUAARA
Sipas shtytozuesve te njezive buxhetore

Nr	shfytuezesi i buxhetit	Paga dhe medite	Malta dhe sherb te planifikuara	Shpenz komunale	Subvencione	Investimet kapitale
1	Zyra e Kryetarit	Te planifikuara te hargjaura	€17,389.50	€16,136.87	€19,992.00	€0.00
2	Administrata		€41,683.50	€39,713.66	€0.00	€1,725.00
3	Zyra per komunikim		€1,332.50	€1,219.11	€0.00	€0.00
4	Zyra per barazi gjinore		€1,837.50	€1,783.98	€0.00	€0.00
5	Zyra e kuvendit komunal		€18,750.00	€15,285.46	€0.00	€0.00
6	Buhxet dhe financa		€11,692.25	€11,585.70	€0.00	€0.00
7	Inspektioni		€8,371.75	€7,039.97	€0.00	€0.00
8	Sherbimet publike- mbrojtja civile		€18,667.50	€17,192.87	€0.00	€0.00
9	Zyra per komunitete		€7,807.25	€7,729.52	€0.00	€0.00
10	Buqiesi, pyllari dhe zhvill rur.		€11,454.00	€11,025.13	€0.00	€0.00
11	Zhvillim ekonomik		€7,206.50	€5,882.28	€0.00	€28,656.90
12	Urbanizem		€0.749.50	€8,106.92	€0.00	€0.00
13	Shendetesi, dhe mbrojtje prim.shend.		€58,829.00	€58,237.65	€0.00	€1,000.00
14	Sherbimet sociale		€6,253.25	€5,997.48	€0.00	€0.00
15	Kultur rini, dhe sport		€9,361.00	€10,167.56	€0.00	€500.00
16	Administr arsim		€9,547.50	€8,841.31	€0.00	€0.00
17	Arsimi i mesem		€47,040.25	€48,117.99	€2,560.10	€0.00
18	Arsimi filter		€181,112.75	€181,132.60	€14,580.33	€0.00
19	Arsimi parashkollor-kopjshet		€3,275.00	€3,124.42	€0.00	€0.00
	Gjittsej:		€472,360.50	€456,332.98	€37,132.43	€11,617.00
						€1,725.00
						€50,537.92

Mjetet e planifikuara per tremujorin e pare 2018. Per paga dhe medite kane qene te planifikuara ne vlera prej 472,360.50 Euro kurse te shpenzuara jene vlera prej 456,332.98 Euro e shprehur ne perqindje 97.03 %.

Per malta dhe sherbime jane hargjuar me vlera prej 37,132.43 Euro.

Per shpenzime komunale jane shpenzuar ne vlera prej 11,617.00 Euro.

Per subvencione jane shpenzuar ne vlera prej 1,725.00 Euro.

Per shpenzime kapitale jane shpenzuar ne vlera prej od 50,537.92 Euro.

ZYRA E KRYETARIT 6030

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Munigj	Paga	Mall e shert.	Shuma	Subvencione	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€5,791.82	Shp mat. et.	€240.00	Sub ent. jopublike	€1,725.00	
2	Paga	Shkurt	€5,474.98	furniz. zyres	€2,343.91			
3	Paga	Mars	€4,872.07	Drek zyt	€1,559.80			
				furn. Me ush pje	€2,051.83			
				Shp tjet te konti	€5,726.74			
				servis auto	€4,522.00			
				regjist. i autom	€295.78			
				parsje tjet.	€667.00			
				shpenz. antaresis	€990.00			
				derivate	€1,693.94			
	Gjithsej		€16,138.87			€19,992.00		€1,725.00
								€37,855.87

Per paga dhe medite kane qene te planifikuar ne vler prej 17,389.50 Euro kurse jane shpenzuar ne vler prej 16,138.87 Euro ne projekte eshte 92.80 %
Per malita dhe shembime Jane shpenzuar ne vler prej 19,992.00 od Euro

Per subvencione Jane shpenzuar qjetet ne vler prej 1,725.00 euro.

ADMINISTRATA 16330

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

Nr	I loji i shpenzimeve	Muajj	Paga	Mall e sherb.	Shuma	Ops. Usluge	Iznos	Gjithsej
1	Paga	Janar	€13,111.04					
2	Paga	Shkurt	€13,083.64					
3	Paga	Mars	€13,518.98					
	Gjithsej		€39,713.66					€10,117.00
								€49,830.66

Per paga dhe medite kane qene te planifikuar ne vler prej 41,683.50 Euro kurse Jane shpenzuar ne vler prej 39,713.66 euro, ne perqindje eshte 95.27 %.

Per shpenzimet komunalet Jane shpenzuar ne vler 10,117.00 euro

ZYRA PER KOMUNIKIM 16490
Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

Nrherri	Muaji	Paga	Mall e sherb.	Shuma	Iznos	Gjithsej
1	Paga	Janar	€426.71			
2	Paga	Shkurt	€426.20			
3	Paga	Mars	€426.20			
	Gjithsej		€1,279.11			

Per paga dhe medite kane qene te planifikuar ne vler prej 3,325.00 Euro kurse Jane shpenzuar ne vler prej 1,279.11 euro ne perqindje eshte 96.00 %.

ZYR~~RA~~ PER BARAZI/GJINORE 16530
P~~A~~ S~~Q~~YRA tabelare e shpenzimeve per periu~~dh~~n Janar - Mars 2018

Nr.	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mal. e sherb.	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€596.10			
2	Paga	Shkurt	€593.94			
3	Paga	Mars	€593.94			
	Gjithsej				€1,783.98	

Per ~~z~~ paga dhe medite kane qene te planifikuar ne vler prej 1.837.50 Euro kurse Jane shpenzuar ne vler prej 1.783.98 euro, ne perqindje eshte 97.00%.

ZYR~~RA~~ e kuvendit komunal 16930
P~~A~~ S~~Q~~YRA tabelare e shpenzimeve per periudhën Janar - Mars 2018

Nr.	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mal. e sherb.	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€4.579.86			
2	Paga	Shkurt	€4.996.97			
3	Paga	Mars	€5.678.63			
	Gjithsej				€15,255.46	

Per ~~z~~ paga dhe medite kane qene te planikuara ne vler prej 18.750.00 Euro kurse Jane shpenzuar ne vler prej 115.255.46 euro, ne perqindje eshte 81.30 %.

BUDGET DHE FINANCA 17530
P~~A~~ S~~Q~~YRA tabelare e shpenzimeve per periudhën Janar - Mars 2018

Nr.	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mal. e sherb.	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€3.858.28			
2	Paga	Shkurt	€3.853.71			
3	Paga	Mars	€3.853.71			
	Gjithsej		€11,565.70			

Per ~~z~~ paga dhe medite kane qene te planifikuar ne vler prej 11.692.25 Euro kurse Jane shpenzuar ne vler prej 11.565.70 euro, ne perqindje eshte 98.90 %.

INSPEKSIONI 16659
P~~A~~ S~~Q~~YRA tabelare e shpenzimeve per periudhën Janar - Mars 2018

Nr.	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mal. e sherb.	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€2.350.19			
2	Paga	Shkurt	€2.344.89			
3	Paga	Mars	€2.344.89			
	Gjithsej				€7,039.97	

Per ~~z~~ paga dhe medite kane qene te planifikuar ne vler prej 8.371.75 Euro kurse Jane shpenzuar ne vler prej 7.039.97 euro, ne perqindje eshte 84.00 %.

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall e sherb.	Shuma	Invest.kapit.	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€5,734.91				Mimbrog.	€12,957.02
2	Paga	Shkurt	€5,728.98					
3	Paga	Mars	€5,289.98					
	Gjithsej		€17,192.87				€12,957.02	€30,159.89

Per paga qe medite kane qene te planifikuara ne vler prej 18,667.50 Euro kurse lana shpenzuar ne vler prej 17,192.87 euro, ne perqindje eshte 92.40%
Per shpenzime kapitale lana shpenzuar ne vler prej 12,957.02 Euro

ZYRA PER KOMUNITETE 19650

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall e sherb.	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€2,578.96			
2	Paga	Sikuri	€2,575.28			
3	Paga	Mars	€2,575.28			
	Gjithsej		€7,729.52			

Per paga qe medite kane qene te planifikuara ne vler prej 7,807.25 Euro kurse lana shpenzuar ne vler prej 7,729.52 euro, ne perqindje eshte 99.00%.

BUJQESI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL 47030

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall e sherb.	Shuma	Kapitale	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€3,679.19			Furnizime mjet bujq.	8,914.01	
2	Paga	Shkurt	€3,672.97					
3	Paga	Mars	€3,672.97					
	Gjithsej		€11,025.13				8,914.00	19,939.13

Per paga qe medite kane qene te planifikuara ne vler prej 11,454.00 Euro kurse lana shpenzuar ne vler prej 11,025.13 euro, ne perqindje eshte 96.20%
Per shpenzime kapitale lana shpenzuar ne vler prej 8,914.00 Euro

ZHVILLIM EKONOMIK 48030

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall e sherb.	Shuma	Invest.kapit.	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€1,965.20			Permb.pribat	10,876.90	
2	Paga	Shkurt	€1,958.81			Ndliqimi	3,000.00	
3	Paga	Mars	€1,958.81			Matr per ndrti	14,780.00	
	Gjithsej		€5,882.82				28,656.90	€34,539.72

Per paga qe medite kane qene te planifikuara ne vler prej 7,206.50 Euro kurse lana shpenzuar ne vler prej 5,382.28 euro, ne perqindje eshte 81.60%
Per shpenzime kapitale lana shpenzuar ne vler prej 28,656.90 Euro

UJR BANZEM

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

66455

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.e sherb.	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€2.705.14			
2	Paga	Shkurt	€2.700.89			
3	Paga	Mars	€2.700.89			
	Gjithsej		€8,106.92			

Per paga dhe medite kane qene te planifikuar ne vler prej 10.749.50 Euro kurse janë shpenzuar ne vler prej 8.106.92 euro, ne perqindje eshte 75.40 %.

SHENDETESIA PRIMARE

74800

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.e sherb.	Shuma	Shpenz.kom.	Shuma
1	Paga	Janar	€19.432.77				€1.000.00
2	Paga	Shkurt	€19.397.25				
3	Paga	Mars	€19.407.65				
	Gjithsej		€58.237.67				€1.000.00

Per paga dhe medite kane qene te planifikuar ne vler prej 58.829.00 Euro kurse janë shpenzuar ne vler prej 58.237.65 euro, ne perqindje eshte 99.00 % per shpenzimet komunale janë hargjuar ne vler prej 1.000.00 Euro.

SHERBIMET SOCIALE 75646

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.e sherb.	Shuma	Shpenz.kom.	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€ 2.001.54					
2	Paga	Shkurt	€ 1.997.97					
3	Paga	Mars	€ 1.997.97					
	Gjithsej		€ 5,997.48					

Per paga dhe medite kane qene te planikuara ne vler prej 6.253.25 Euro kurse janë shpenzuar ne vler prej 5997.48 euro, ne perqindje eshte 96.00 %.

KULI UJR RINI DHE SPORT 85030

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.e sherb.	Shuma	Shpenz.kom.	Shuma
1	Paga	Janar	3.392.94				€ 500.00
2	Paga	Shkurt	3.387.31				
3	Paga	Mars	3.387.31				
	Gjithsej		10.167.56				€ 500.00

Per paga dhe medite kane qene te planikuara ne vler prej 9.361.00 Euro kurse janë shpenzuar ne vler prej 10.167.56 euro, ne perqindje eshte 108.01 %.

Administrata arsim. 92 f50

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall e sherb.	Shuma	Shpenz.kom.	Siuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€ 2.944,51	Kontraktjera	€ 2.200,00			
2	Paga	Shkurt	€ 2.939,99	Ushq.pije	€ 39,10			
3	Paga	Mars	€ 2.957,21	Dreka	€ 321,00			
	Gjithsej		€ 8,841,81					

Per paga dhe medite kane qene te planifikuar ne vler prej 9.547,00 Euro kurse janë shpenzuar ne vler prej 8.841,81 euro ne perqindje eshte 92,60 %.

ARSIMI I MESEM 95070

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall e sherb.	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€ 16.052,97	Kontraktjera	€ 2.200,00	
2	Paga	Shkurt	€ 16.032,51	Ushq.pije	€ 39,10	
3	Paga	Mars	€ 16.032,51	Dreka	€ 321,00	
	Gjithsej		€ 48,117,99		€ 2.560,10	€ 50.926,89

Per paga dhe medite kane qene te planifikuar ne vler prej 4 / 040 25 Euro kurse janë shpenzuar ne vler prej 48.117,99 ne perqindje eshte 102 %.

Per malita dhe sherbime janë shpenzuar ne vler prej 2.560,10 Euro

ARSIMI FILLOR 93870

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall e sherb.	Shuma	Gjithsej
1	Paga	Janar	€ 60.213,68	Kontraktjera	€ 12.006,18	
2	Paga	Shkurt	€ 60.442,45	derivate	€ 2.109,15	
3	Paga	Mars	€ 60.476,47	paisje tjr	€ 285,00	
	Gjithsej		€ 181,132,60	shpenz internet	€ 180,00	
					€ 14.580,33	€ 178.749,84

Per paga dhe medite kane qene te planifikuar ne vler prej 181,132,75 Euro kurse janë shpenzuar ne vler prej 181,132,60 ne perqindje eshte 100,00 %.

Per malita dhe sherbime janë shpenzuar ne vler prej 14.580,33 Euro

AKR SIMI PARASHKOLLOR KOPSHTË

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen Janar - Mars 2018

Nr	I loji i shpenzimeve	Muaj	Paga	Gjithsej
1	Paga	Janar	€ 1,042.36	
2	Paga	Shtator	€ 1,041.03	
3	Paga	Mars	€ 1,041.03	
	Gjithsej		€ 3,124.42	

Per paga dite medite kane qene te planifikura ne vler prej 3,275.00 Euro kurse janë shpenzuar ne vler prej 3,124.42 ne perqindje eshtë 35.35 %

Z. Srdjan Iodorovic

Drejtore per Buhxet dhe financa

Z. Svetislav Franovic

Kryetar i Komunes

vula